

VENDIM
Nr.168, datë 22.3.1993

**PËR NDËRMJETËSIMIN NË ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJEVE PARA
LIDHJES SË KONTRATËS KOLEKTIVE TË PUNËS**

Në zbatim të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës", me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve para lidhjes së kontratës kolektive të punës fillimisht bëhet nga ndërmjetësit e autorizuar, të shpallur nga Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

2. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë përcakton procedurën për zgjedhjen dhe regjistrimin e ndërmjetësve.

Lista e ndërmjetësve shpallet nga ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë.

3. Ndërmjetës mund të jetë çdo person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me arsim të lartë ose me njohuri të veçanta në atë fushë, me kusht që të pranojë vullnetarisht detyrën e ndërmjetësit.

4. Kur palët, brenda 60 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim për zhvillimin e bisedimeve, nuk bien dakord për lidhjen e kontratës kolektive, ato, në marrëveshje ndërmjet tyre, duhet të zgjedhin një ndërmjetës nga lista e shpallur për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Kur palët nuk bien dakord për caktimin e ndërmjetësit, ministri i Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, mbi bazën e kërkesës së tyre, cakton përfundimisht ndërmjetësin.

5. Ndërmjetësi, brenda 15 ditëve nga data që ka marrë njoftim për mosmarrëveshjen ndërmjet palëve, u komunikon atyre me shkrim propozimin për zgjidhjen e saj.

6. Ndërmjetësimi quhet i pasuksesshëm, nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet brenda 30 ditëve nga data në të cilën ndërmjetësi ka marrë njoftim për të.

7. Shpenzimet për ndërmjetësim përballohen në mënyrë të barabartë nga të dyja palët dhe parapaguhet a lidhet ndonjë marrëveshje.

8. Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, përcakton kufijtë e pagesës së ndërmjetësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit nr.7673, datë 17.2.1993 "Për kontratat kolektive të punës".

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi